



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQËNIES SOCIALE
SPITALI RAJONAL “MEMORIAL” FIER

Nr. ____ Prot

Fier më __/__/2026

Lënda : Njoftim për vend të lirë pune

Drejtoria e Spitalit Rajonal “Memorial” në Fier, shpall njoftimin për konkurim të hapur, për pozicionin si vijon :

- Specialist, në Sektorin e Koordinimit me Pacientin (një vend pune, me afat të caktuar)

1. Specialist, në Sektorin e Koordinimit me Pacientin në Drejtorinë e Kujdesit për Pacientin, pranë Spitalit Rajonal “Memorial” Fier.

Kandidatët që konkurojnë për vendin e punës në pozicionin “Specialist”, në Sektorin e Koordinimit me Pacientin, duhet të plotësojnë këto kritere:

1. Të jenë shtetas shqiptarë .
2. Të kenë diploma universitare në shëndet publik;
3. Të kenë aftësi të shkëlqyera komunikimi dhe prezantimi;
4. Të mos jetë dhënë ndaj tij/saj masa disiplinore e largimit nga puna.

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë sekretarisë së Drejtorisë në Spitalin Rajonal ‘Memorial’ në Fier këto dokumenta :

- a. Jetëshkrimi i kandidatit (CV) (e detyrueshme)
- b. Fotokopje e kartës së identitetit (e detyrueshme)
- c. Diploma Universitare dhe lista e notave. Për kandidatët që kanë studiuar jashtë vendit, diploma e tyre duhet të jetë e njohur nga struktura përkatëse (e detyrueshme)
- d. Diploma e Specializimit dhe lista e notave. Për kandidatët që kanë studiuar jashtë vendit, diploma e tyre duhet të jetë e njohur nga struktura përkatëse (e detyrueshme)
- e. Fotokopje e librezës së punë
- f. Dëshmi të kualifikimeve shkencore (gradë ose titull akademik/shkencor)
- g. Dëshmi të njohjes të gjuhëve të huaja

- h. Certifikatat e pjesëmarrjes në aktivitetet e edukimit në vazhdim të ndjekura brenda dhe jashtë vendit
- i. Formulari i Vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore (e detyrueshme)
- j. Raport aftësie për punë, i tre muajve të fundit (i detyrueshëm në momentin e fillimit të detyrës)
- k. Referenca nga punëdhënësi i mëparshëm (nëse ka).

Mosparaqitja e dokumentave ose mosparaqitja e plotë e tyre, sjell s'kualifikim të kandidatit;

Kandidatët e interesuar duhet të paraqesin dokumentat brenda 7 (shtatë) ditëve nga data e shpalljes në faqen zyrtare të Spitali Rajonal “Memorial” Fier, “Vende të lira pune”, në Buletinin e njoftimeve zyrtare të Agjensisë së Prokurimeve Publike si dhe e publikuar në platformën “puna.gov.al”.

Përzgjedhja e kandidatit fitues do të bëhet nëpërmjet konkurimit me dosje dhe me intervista të drejtëpërdrejta.

Kandidatët konkurues do të njoftohen elektronikisht për rezultatet paraprake të konkurimit, orën , datën e intervistës dhe për shpalljen / njoftimi i fituesit.